

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/kur-james-bondi-kthehet-ne-menekshe-telendisja-ne-te-lenovele-turke-e-nj-i587951
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:56:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 16:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a9dd7deaca3cb534559adfbde43fa9d4a929bada4c7f44853eced1e7abdbaf5
TEKSTI	3890e337ca40161d47d4669ae9680c26319faf28265cc373120add8d0acd74d8
PAMJA	80f48b6e7182b5fdee9242b6c0361d944c7f6d3354313e0f9af1a72360bc039d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a41bd78482e1cd6ddd912e826dbb604ccbb93bb0747a33e9eaf5a0bfd83b4a93
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a41bd78482e1cd6ddd912e826dbb604ccbb93bb0747a33e9eaf5a0bfd83b4a93>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



1e [Ne kerkim per trahk nderkombetar kokaine, arrestohet ne Rusi Shpetim AliuZeljensky flet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lutte fundit](#)

Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story



23 Shtator 2026, 18:05Politika TEMA



Nga Ylli Pata

Historia që SPAK i dhuroi publikut ishte një fabul e mrekullueshme. Një kryespiune nga Kosova që telefonon një garipi durrsak në panik, në stres që kërkon një ngushëllim. Një fjalë, një gjest të butë që t'i qetësojë shpirtin, mendjen e ikur për bojë, ndoshta edhe të rënduar nga municione izotrope.

Por askush nuk i flet, askush prej miqve që kishte ngrënë e pirë nuk i përgjigjet. Telefoni, i cili nuk i pushonte asnjë minutë, në çdo kohë të ditës 24/7 është shurdh.

Është vetëm një grua që në momentin më të vështirë të jetës së tij mundohet ta qetësojë. Shpirt, mbledh mendjen. Gjërat duhet t'ja lëmë kohës. Por garipi është në stres dhe e çmend me telefon. Gruaja ja kthen: Jam në takim të rëndësishëm, me shefin, me njërin me tjetrin....

Kjo histori është një material perfekt për një James Bond shqiptar, ku Gysi është 007-a e Vlora zonja M.

Por s'ka, e kthyen në telenovelë trogloditët e paneleve, duke e keqpërdorur një material të artë për një film që ndoshta vitin e ardhshëm mund të na kishte përfaqësuar në Oscar. Se këtë vit, shyqyr zotit, është pranuar kryevepra e Roland Sejkos "Film di Stato", që po bën namin në kinematë italiane e sipas gjasave do na sjellë një lajm të mirë nga Los Angelesi

Udhëzime nga autori të filmave nga Edo Rina

E gjithë fabula që na ka sjellë deri tani prokuroria speciale është magjepse, mjafton ta studiojmë me kujdes. Pasi aty ka dilema, ka dramë, ka edhe romancë, po mbi të gjitha ka suspense siç i thonë francezët. Por që ta sjellësh gjithë këtë material në skenë duhet Vera Grabocka, e jo trogloditët që e shpërrojnë gjithë këtë kryevepër letrare në Menekshe.

Ka manual për të kthyer një ngjarje reale në vepër letrare e më pas në kinematografi. Duhet mëndje, jo britma panelesh. "Dueli i Heshtur", një nga kryeveprat shqiptare të filmit ka pasur firma të rënda, ku skenari është i Nasho Jorgagjit e regjia e Dhimitër Anagnostit. Pa përmendur aktorët: Ndreke Luca, Rikard Larja, Reshat Arbana, Bujar Kapexhiu.

Një spy story e punuar me kujdes mund të na çojë në Netflix e të bëjë bujë. Për këtë kërkon dramë; që ka, romance; që paska, protagonistë tërheqës, të cilët ekzistojnë. Janë të gjithë elementët, vetëm se duhet një kujdes në renditjen dhe nuancat e dialogjeve.

Do të dilte një kryevepër deri në dërgimin e çështjes në gjyq. E pastaj ta ndjekim procesin siç ndjekim Gërdecin, ku Gysi del nga gjykata i buzëqeshur e ashtu tërheqës dhe përshëndet para kamerave. Ku e ke Vlorën e pyesin? Unë jam nga Durrësi thotë duke qeshur dhe ikën me avokatin...

TemA

16 Komente

N nje e vertet e modhe.....

23 Shtator 2026, 18:10

Hahahaha Turkish telesehir...!? Po pse cfare tjetër prisnit ju ne nje bourdhelo islamikesh si Albaniston...!? Nuk behet shteti stani me sunite lepuj o beqiiiiiiiiiraaaaaaaaa..... hahahaha!

↩ **Përgjigjuni**

👍 8 🗳 9 ❤ 0

D Dire Straits !!!!

23 Shtator 2026, 18:46

Ne kohen e legjendes Enver Hoxha , filmat dhe telenovelat , i shikonte me pare Enveri , biroja...dhe pasi jepnin miratimin , ia servinin publikut.....nese kjo histori , sipas Yllit , eshte telenovele , si ka mundesi qe bojaxhiu dhe besniket e tij nuk e kane pare me perpara se Spak ta shfaqte ne publik.....apo e pa bojaxhiu para se te ikte ne Amerike , dhe pastaj , beri sikur nuk dinte gje ...dhe na u hoq si "Gangster i zbatimit te ligjit" dhe e shkarkoi menjehere Vloren ?.....eh , imagjino sikur ne vend te Vlores te ishte....Bela , si do sillej valle bojaxhiu trim ???!!!

↩ **Përgjigjuni**

👍 0 🗳 14 ❤ 0

R Rrobt ylli

23 Shtator 2026, 19:26

Po c thua o ylli o t qr. e kupton qe gjithe shteti per vitet e fundit ka qene ky nga durrsi dhe kjo nga kosova. Ptu fare e keqe patronazhistesh e komunistesh qe e degjeneruat kete vend

↩ **Përgjigjuni**

👍 1 🗳 7 ❤ 0

L Lopa qe ra ke gropa e Gysit

23 Shtator 2026, 18:21

Kjo or ti Pata qe nuk ben veze te arta eshte emblema e Shtetit te Korruptuar: P.P.P Te kujtohet sa u perfolen ato PPP - te e Rames (Partneritet Privat Publik)? Ato PPP jane ilustrim i Trinise se Shenjte te Tranzicionit - Pushtet. Para. P@ dh . Kjo Lopa e Kosoves e ka ngrene rendshem grepin papagall te Agasit. Nga qejfi per papagall ka rene ne kurthin e Agasit (video) dhe eshte shantazhuar prej tij. Duket si melodrame romantike por Lopa paska qene kaq e trashe sa i shkruaka sms , kur e di qe gjithcka le gjurme dhe dekriptohet.

↩ **Përgjigjuni**

👍 6 🗳 8 ❤ 1

A Aron

23 Shtator 2026, 18:21

Pershkrim satirik i kesaj telenovele qe po shikojme e degjojme, e si per cudi SPAK pa i bere akoma te ditur vete te akuzuaret akuzat e ligjshme perhap gjitheandej gjithe kete liber trill per te ekzaltuar publikun me hitin e rradhes. Te presim per vazhdimin se fundi akoma nuk dihet, edhe pse

shpesh SPAK mund te kete bere te mundur qe te largoj nga skena politike apo administrative disa figura qe edhe mund tu prishin pune, por qe ne fund nuk jane denuar per ato qe ne fillim eshte bere buja.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 20 🗳️ 0 ❤️ 0

P Policia ushtarake dhe kriza energjetike

23 Shtator 2026, 18:32

SHISH ishte drejt shpërbërjes pasi metoda primitif e punës, bëri që të bie në sy mënyra vazhduese e tyre.Për tu bërë operator i shërbimit informatif, në vëndin tonë mjafton të jesh antar i një partie politike, ndërsa duke ditur që çdo shtet ka shërbim sekret dhe për tu bërë pjes e tyre ka një sërë kushtesh për të plotsuar.Duhet të dish 5 gjuhë të huaja, duhet të kesh shëtitur gjysmën e botës, të punosh në mënyr autonome informatikën, të njohësh 30% të njerëzve 30 vjeç minimumi dhe 50 vjeç maksimumi, të njohësh politikën e vëndit dhe të jashtmen, ndërsa te ne operatori qendron në kafene dhe ndëgjon opinionin e qytetarëve.Në Rusi, oficeri i kgb u bë President i federatës, në SHBA ish Presidenti Bush father ishte drejtor i CIA para se të vinte në shtëpin e bardhë, ndërsa staffi i SHISH duhet futur në incenerator ekzistues që të tymosen dhe të mos kthehen më.Nën hundën e SHISH ,uçk e Thaçit kishte dy baza në veri të vëndit.Që prej 1913, SHISH ka qënë funksional dhe i panvarur, por duke qëndruar spektator në problemet e vëndit ka bërë që vëndi gjithmon të qëndroj në diktatur dhe luftë klasash.Të huajt që vijn në vëndin tonë duhet të verifikohen dhe survejohen që në porte, aeroporte, pika kufitare ., dhe jo surpriza rezistuese pas grabitjeve, akteve vrasëse apo largimit ilegal nga territori vëndit.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 1 ❤️ 1

A Anri

23 Shtator 2026, 18:36

Sa e banalizon ky Pata..Nuk ja vlen te komentosh te kjo corbe e prishur..Njesoj si vete Tema qe ndryshon kryekeput nga Tema qe kemi njohur..

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 8 ❤️ 1

I iliri

23 Shtator 2026, 19:05

kur dalin emisione si perputhen bigbradher e te tjera keto do rinia shqiptare se mos duan shkolle ,te epur per aventura,tradheti,luks fshataresk,pasurim i fshatareve , parajsa e qejfit eshte kthyer ky vend,Perse kjo frym mos te jete ne administrata,ne pushtet

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 2 🗳️ 1 ❤️ 0

N Napoleon

23 Shtator 2026, 19:07

DUMDUMANI PJELLE E ISLAMIT POLITIK DHENI AJATOLLAH BIRRISHES.....ASGJE SESHTE E VERTETE....

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 11 🗳️ 0 ❤️ 0

K kris

23 Shtator 2026, 19:14

Ikin flamingot por do te kemi patat

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 3 🗳️ 5 ❤️ 0

X Xha Braho

23 Shtator 2026, 19:19

Ju kujtohet ata perversat ne kohen e monizmit, qe rrinin te fshehu ne shkrete te Liqeni Artificial dhe pergjonin çiftet? Keshtu jane bere dhe prokuroret e SPAK, njerez provincial dhe perverse, te fiksuar pas pergjimeve dhe telefonave. Si duket masturbohen duke transkriptuar bisedat me karakter romantic. Jane te apasionuar pas "Shtepise te Gjetheve", por pergjimeve e saj nuk perdoreshin si prove. Ato vertetonin faktin vetem.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 8 🗳️ 1 ❤️ 1



Detari

23 Shtator 2026, 19:43

Kete e ka perdorur rama per te hedhur kocka te spaku dhe per te mbuluar ron jefetin. Filluan prape si me breket e ajolles meroja me shoke

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 1 ❤️ 0



Humore SPAKuuu

23 Shtator 2026, 19:59

Humore SPAKuuu pa shije . Ke folur me Agasi , po tha zonja ishte bashkpuntor i sherbimit kam folur. Ke shkruar mesazhe me Ballen , Balluku po me ke do shkembente mesazhe zonja me gjitholloget Tan Hoxha dhe Klodiana Lala...

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 5 🗳️ 0 ❤️ 0



Te hongsha hunen

23 Shtator 2026, 20:00

Epo te te qije ky pinoku eshte tmerr

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 1



Vlorë 97

23 Shtator 2026, 20:15

Ore nje pyetje kam une pa e lexu fare se merret vesh cfr shktuani: JU TË MEROS APO TË TEMËS A KENI TURP? CIPË NJERIU A KENI? ptu. Sikter!!

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 1 🗳️ 2 ❤️ 0



Totololi

23 Shtator 2026, 20:23

Ky Pata, nje nga qurret e Ramutit, e thjeshtezon shume ate qe ka ndodhur dhe gati-gati e nxjerre heroine ate baxhellen. Shqiptaret kane lufte te madhe dhe te gjate per te bere me gjithe keta ndyresira sahanlepires.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 3 ❤️ 0

🗨️ Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.